



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.40 dt.14.02.1997

**PER  
DHENIE FOND PAGE PER PERSONELIN E NDERMARRJES  
PRODHIMEVE TE ARTIZANATIT NR.2 TIRANE**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.14.02.1997, shqyrtoi relacionin për dhënie fond page për Ndërmarrjen e Prodhimeve të Artizanatit Nr.2 Tiranë, paraqitur nga Sektori Zhvillimit të Industrisë.Këshilli Bashkiak mbështetur në kompetencat që i jep ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” Nr.7582, dt,10.06.1992, neni.14, pika.10, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.673, dt.29.11.1995 “Për kriteret e përdorimit të të ardhurave të organeve të Pushtetit Lokal”, pika.2, nëndarja.”a”

**V E N D O S I;**

1. Ndërmarrja Prodhimeve të Artizanatit Nr.2 Tiranë ti jepet çdo muaj fondi për pagesën e drejtorit dhe rojes, deri në fund të 3 muajorit të parë të vitit 1997, ndërkohë në fund të muajit Mars të këtij viti të paraqitet një relacion shpjegues për gjendjen e praktikave shkresore për privatizimin e kësaj ndërmarrje.
2. Paga e Drejtorit të Ndërmarrjes mbështetur në vendimin Nr.623, dt.01.12.1993 dhënë tabelën e pagave dërguar nga Drejtoria e Pagave dhe e Marrdhënieve me Punonjësit e Ministrisë Industrisë dhe Tregtisë me Nr.Prot.660, dt.28.03.1994 është e përcaktuar për degën e industrisë mekanike etj, minimale 6.000 lekë dhe maksimale 7.000 lekë. Sektori i Industrisë propozon pagën minimale 6.000 lekë.

Drejtori.....Paga	6.000 lekë
Roje.....	5.675 lekë
-----	
SHUMA :	11.675 lekë
Sig.Shoq. 34.2% x 11.675 =	3992.8 lekë
GJITHSEJ :	15.667.8 lekë

3. Për kryerjen e pagesës ngarkohet Sektori i Zhvillimit Industrisë dhe Drejtoria e Financës.

**K R Y E T A R I  
ORHAN SAKIQI**

